

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Grupi kriminal i AKSHI-t hap klinikë kundër plakjes në emrin e Arlinda Mekos (kontabilistja e Rrytajve), si po sfidohet SPAK dhe shqiptarët me kështjella, carter, jaht, orë 650 mijë euro dhe verëra 3 milionë euro
ADRESA	https://prapaskena.com/2026/09/25/grupi-kriminal-i-akshi-t-hap-klinike-kunder-plakjes-ne-emrin-e-arlinda-mekos-kontabilistja-e-rrytajve-si-po-sfidohet-spak-dhe-shqiptaret-me-ke-shtjella-carter-jaht-ore-650-mije-euro-dhe-verera-3/
BURIMI	prapaskena.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 14:11:16 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 13:57:44 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	77683532655d0de1c4c80e1d66cf672a0fcbdf36527fc3e2d20d302109449682
TEKSTI	f7d0b021e61e2132e10c52c3cb6b6d0e1ab30dea9ee055341feaea72d34328e4
PAMJA	4984141538ab1088382539934e525e72f5ea2c71ec21ec528e001a568185d2bb

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	293bb3323e7aba77ea2e73281e16f11b1130ff5172abd257791f07137e775792
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	3a6c0ee943067392b175e06ac07a7b9996bbd474953cea4f063ab0e5555023da
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/293bb3323e7aba77ea2e73281e16f11b1130ff5172abd257791f07137e775792>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.



Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Grupi kriminal i AKSHI-t hap klinikë kundër plakjes në emrin e Arlinda Mekos (kontabilistja e Rrytajve), si po sfidohet SPAK dhe shqiptarët me kështjella, carter, jaht, orë 650 mijë euro dhe verëra 3 milionë euro


Investigim

Publikuar: 25/09/2026

f X



Kështjella, vila, resorte, charter privat, makina luksoze, apartamente, orë luksoze Richard Mille 650 mijë euro, 3 milionë euro verëra, jaht privat, pallate, llogari miliona euro, qindra milionë euro tendera korruptivë, pengmarrje, shantazh, kartel kompanish për pastrim parash, rreth dashnoresh në poste kyçe publike, kapje të Shërbimit Informativ Shtetëror, kapje të policisë, AMP, hipotekës, IKMT-së, basteve, call centrave, tregut të shpërndarjes së drogës, ndërtimeve pa leje etj. Grupit kriminal të AKSHI-t i mungonte vetëm një klinikë estetike kundër plakjes, për të zhdukur gjurmët e moshës dhe kohës.



Me të lexuarat

Shantazhi /
Kryespiunia
Vlora Hyseni
filmoi
politikanë dhe
magjistratë me
dashnorë që
hynë në hotel për
marrë mandatin
e radhës,
përmbaresit
privatë i
besojnë sërish
drejtimin e
DPS-së



arrestua në
Rusi, zbulohet
portreti i
Shpëtim Aliut!
'Kumbari' që
fikozoi...
Shefin e
Komisariatit të
Fushë-Krujës
Elton Shadin
e rrahin me
shpulla në mes
të rrugës
Zyrtarët e lartë
dhe krimi i
organizuar u
bënë njësh në
mbrojtje të
Ergys Agasit



Tre muaj pas arratisjes, Ermal Beqiri dhe Gys Agasi, dy protagonistët e grupit të AKSHI-t, në mars të këtij viti, kanë hapur një klinikë luksoze estetike tek Liqeni i Thatë në Tiranë, dyshohet me paratë e korrupsionit me tenderat e AKSHI-t. Bëhet fjalë për një investim me vlerë qindra milionë euro, kamufluar me kompaninë pa kapital Areal Aesthetic Clinic, regjistruar në emrin e Arlinda Meko dhe Alfred Mezini.

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)	M61506037E
2. Data e Regjistrimit	06/03/2026
3. Emri i Subjektit	Areal Aesthetic Clinic
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	05/03/2026
6. Kohëzgjatja	Nga: 05/03/2026
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane SAUK Rruga Hamdi Garunja, Nd.4, Kati 0, Liqeni i Thate , Farke , Sauk 1001
8. Kapitali	1.000,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	2,00
9. Objekti i aktivitetit	1.1. Ofrimi i shërbimeve estetike, kozmetike dhe dermatologjike. Qendër dermoestetike, kabinet mjekësor për vizita dhe trajtime dermatologjike. Shërbime në fushën e estetikës dhe kozmetikës. Shitje e produkteve dhe pajisjeve kozmetike dhe estetike. Çdo veprimtari tjetër ekonomike, e nevojshme dhe/apo e dobishme për realizimin e qëllimit të shoqërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.1.2. Shoqëria do të kryejë çdo lloj veprimtarie të dobishme për arritjen e objektivave të saj, duke përfshirë edhe veprime për shitblerje pasurish të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe pjesëmarrje në kuota dhe aksione në shoqëri dhe ndërmarrje të tjera.
10. Administratori/ët	Arlinda Meko
10.1 Afati i emërimit	Nga: 05/03/2026 Deri:
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore	
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)	

Prestanome e grupit të AKSHI-t për kamuflimin e klinikës Areal, Arlinda Meko thotë se “*për ne, bukuria nuk është thjesht ajo që shohim në pasqyrë, por edhe mënyra se si ndihemi me veten. Në AREAL besojmë te një bukuri e natyrshme, e ekuilibruar dhe e personalizuar, ku estetika ndërthuret me mirëqenien. Vizioni ynë është të ofrojmë kujdes profesional, teknologji moderne dhe një eksperiencë ku çdo klient të ndihet i vlerësuar dhe në duar të sigurta*”.

Në të njëjtën formë po i pastron paratë edhe fraksioni tjetër kriminal i AKSHI-t, me në krye Geront Meçen, Migena Schroeder, Daniel Shimë dhe Sokol Parllakun. Grupi Beqiri-Agasi-Karçanaj u godit nga SPAK, ndërsa grupi i Geront Meçes vijon t'i shpëtojë veprimit të drejtësisë. Dy fraksionet kanë qenë një grup, por u ndanë pas prishjes në pazare.

Roli i Arlinda Mekos dhe Alfred Mezinit në pastrimin e parave të grupit të AKSHI-t

Evidencat konfirmojnë se kontabilistja e Rrytajve, **Arlinda Guri Meko** dhe avokati **Alfred Rushit Mezini** janë protagonistë të një prej linjave kryesore të pastrimit të parave të korrupsionit të AKSHI-t, evazioni fiskal, faturimesh fiktive, falsifikimi dokumentacioni dhe fshehje të ardhurash.

(Arlinda Meko)

Arlinda Meko ka vepruar si derivat dhe kamuflim i **Bedri dhe Rogers Rryta**, babë e bir, pronar i një rrjeti kompanish me aktivitet të dyshimtë, përfshirë edhe kompaninë **Mega Distribution** shpk. Përmes faturimeve fiktive, shpeshherë jashtë objektit të veprimtarisë së kompanive, **Arlinda Meko (Kola)** ka mundësuar pastrimin e jo vetëm parave të korrupsionit të AKSHI-t, por edhe të aktiviteteve të tjera të paligjshme.

Sipas dosjes së SPAK-ut, vetëm përmes një skeme, Bedri dhe Rogers Rryta kanë pastruar përmes kompanisë **Mega Distribution**, me **kontabiliste Arlinda Mekon, rreth 10 milionë euro para korrupsioni të AKSHI-t, duke bërë fatura sikur kanë shitur çokollata dhe biskota.**

Më kontretisht, gjatë viteve 2018, 2020 dhe 2021, **Soft & Solution e Ermal Beqirit** dhe **Fastech e Andis Papa** i kanë faturuar rreth 10 milionë euro fiktivisht kompanisë **Mega Distribution** sikur kanë blerë çokollata dhe biskota.

(Ermal Beqiri dhe Andis Papa)

Rogers Rryta ka deklaruar në SPAK se ka pasur marrëdhënie tregtare me kompanitë e teknologjisë Fastech dhe Soft & Solution, por se nuk mban mend si ka nisur kjo marrëdhënie kur

ai ka qenë administrator i kompanisë së ushqimeve Mega Distribution.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.